



Lagjja Nic, Cagllavicë, Graçanicë, 10500

[kidsacademy-ks.com](http://kidsacademy-ks.com) | 045/049.705.000 | [info@kidsacademy-ks.com](mailto:info@kidsacademy-ks.com)

## Regjistrimi i Fëmijëve në Kids Academy

### Rregullat dhe Procedurat

Prindërit që regjistrojnë fëmijët në Kids Academy, para fillimit të çdo bashkëpunimi, duhet të njohohen me rregullat dhe procedurat e regjistrimit të fëmijëve në Kids Academy dhe të deklarojnë se pajtohen me to.

#### Informata të Përgjithshme

Kids Academy është qendër edukative-arsimore për përkujdesje ditore të fëmijëve të moshës 1 deri në 6 vjeç, bazuar në programin pedagogjik Montessori për edukim, zhvillim dhe rritje të fëmijëve. Kids Academy është themeluar në Shtator të vitit 2012. Për shërbimet që ofron është licencuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovë. Misioni i Kids Academy është krijimi i një vendi të sigurtë, të përshtatshëm, të ngrohtë, dhe të planifikuar mirë për fëmijët e moshës 1 deri në 6 vjeç në përputhje me veçoritë individuale të secilit fëmijë. Kids Academy përqendrohet në kujdesin për zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve dhe në trajtimin e barabartë të tyre duke qenë gjithnjë të vëmendshëm për nevojat e tyre individuale. Përveç përkujdesjes fizike, lojës dhe argëtimit të fëmijëve, Kids Academy është e përqëndruar në zhvillimin e kreativitetit tek fëmijët; ndërtimin e vetëbesimit, pavarësimin, nxitjen e kureshtjes dhe dëshirës për të mësuar. Për më shumë, Kids Academy synon të nxisë interesimin e fëmijëve që të hulumtojnë dhe të mësojnë më shumë për rrethin ku jetojnë.

#### Regjistrimi i Fëmijëve në Kids Academy

Hapi i parë për të regjistruar fëmijën në Qendrën e Përkujdesjes Ditore Kids Academy është plotësimi i aplikacionit i cili mund të gjindet në [www.kidsacademy-ks.com](http://www.kidsacademy-ks.com). Për të

aplikuar për më shumë se një fëmijë duhet të mbushni aplikacion të veçantë për secilin. Aplikacionet pranohen gjatë gjithë kohës, përveç se shqyrtimi i tyre mund të jetë më i ngadalshëm në periudhën kur vendet janë të plotësuara. Pas shqyrtimit të aplikacionit tuaj personeli i Kids Academy mund të ju informojë se si dhe kur mund të filloj mësimin në kopsht fëmija juaj.

### **Pranimi dhe Dorëzimi i Fëmijëve**

Pranimi i fëmijëve bëhet prej orës 7 deri në 9 të mëngjesit. Është e domosdoshme që prindërit të informojnë Stafin e Kids Academy se kush është i autorizuar të marrë fëmijnë nga Kopshti. Nëse ne nuk jemi të informuar me kohë se një palë e tretë ose person i ri do të marrë fëmijnë nga kopshti, ne jemi të detyruar të ndalim fëmijën në kopsht.

Gjithashtu, në rast se prindërit janë të divorcuar ose kujdestarë të vetëm të fëmijës, KA duhet njoftuar nëse ata janë përfaqësuesit ligjor të fëmijës, dhe nëse prindi tjetër, i cili nuk jeton me fëmijën, ka të drejtë të marrë fëmijën nga kopshti apo jo. Të njëjtat rregulla vlejnë edhe për transport. Personeli i Kids Academy duhet të jetë i informuar se kush do të marrë e të dorëzojë fëmijën, veçanërisht kur ky person nuk është prindi i fëmijës.

### **Gjuha e Komunikimit**

Në Kids Academy gjuha e komunikimit është gjuha shqipe. Në baza ditore, përgjatë realizimit të aktiviteteve me fëmijë, edukatorët interpetojnë dhe zhvillojnë aktivitete edhe në gjuhën angleze.

### **Veshja**

Prindërit duhet të kenë parasysh llojllojshmërinë e aktiviteteve në të cilat mund të marr pjesë fëmija përgjatë ditës së mësimin. Lusim prindërit të veshin fëmijët me rroba të rehatshme me të cilat ata mund të lëvizin lirshëm dhe rehatshëm. Megjithëse personeli i kopshtit përkujdeset për mirëmbajtjen e pastërtisë së fëmijëve gjatë qëndrimit në Kids Academy, pjesëmarrja në aktivitete me ngjyra apo loja në natyrë mund të lënë shenja në rrobat e fëmijëve. Është poashtu me rëndësi që fëmijët të kenë veshje të përshtatshme me kohën (me jakne, xhemperë, kapela apo çizme). Rekomandojmë që fëmijët të mbathin atlete të përshtatshme për lojë.

## **Stolitë**

Kopshti nuk merr përgjegjësi për ruajtjen e shnollave apo stolive të ngjashme në kopsht, siç janë zingjirët, vathët, dhe gjërat e tjera të imëta. Për më shumë, për t'iu shmangur humbjes së këtyre stolive, si dhe mundësisë për lëndime gjatë aktiviteteve të ditës, fëmijët duhet të vijnë në KA pa stoli të tilla.

## **Lodrat**

Mjetet e punës dhe lodrat të cilat përdoren në Kids Academy janë të veçanta në ndërtimin dhe funksionet e tyre që stimulojnë zhvillimin intelektual e kreativ të fëmijës suaj.

Për të qenë çdo herë të drejtë me të gjithë, nuk lejojmë që fëmijët të sjellin lodra apo kostume personale nga shtëpia. Sjellja e gjërave personale rezulton në dallime dhe pakënaqësi tek bashkëmoshatarët, gjë që ndikon në atmosferë jo të barabartë tek grupi.

## **Shëndeti**

Duke mbajtur në mend të parë shëndetin e fëmijës tuaj, është e domosdoshme që, me rastin e regjistrimit të fëmijës në kopsht, të sillen dëshmi për vaksinimin e tij dhe të qartësohet detajisht gjendja e tij shëndetësore. Në rast të ndonjë ftohjeje të fëmijës, është me rëndësi që ju të siguroheni se fëmija është shëruar plotësisht para se ju ta sillni atë përsëri në kopsht. Kjo mënjanon shpërndarjen e ftohjes tek fëmijët e tjerë dhe siguron qëndrim të sigurtë e të parrezikshëm për të gjithë fëmijët në kopsht. Stafi i Kids Academy do të lajmërojë prindërit në rast të shqetësimeve shëndetësore për fëmijën e tyre.

## **Medikamentet**

Kopshti Kids Academy nuk mbanë dhe nuk shpërndanë medikamente tek fëmijët e kopshtit gjatë qëndrimit të fëmijës në kopsht.

## **Rastet Emergjente**

Në rast të shenjave të ndonjë rreziku shëndetësor për fëmijën tuaj gjatë qëndrimit në kopsht, ju do të informoheni menjëherë në telefon përmes personelit. Në rast se një fëmijë ka gjakderdhje serioze, humb vetëdijën, ka probleme në frymëmarje apo ka lëndim serioz trupor, stafi i Kids Academy do të jap ndihmën e parë dhe të lajmërojë emergjencën, si dhe familjen, menjëherë.

## **Mungesat e Fëmijëve**

Kopshti duhet të informohet paraprakisht për çdo mungesë të fëmijës në kopsht, qoftë ajo mungesë një ditore apo më e gjatë.

## **Ruajtja e Vendit**

Kopshti duhet të jetë i informuar se fëmija juaj do të mungojë në kopsht për një periudhë më të gjatë kohore në mënyrë që atij t'i ruhet vendi. Ne jemi të kushtëzuar të llogarisim edhe vendet të cilat i ruajmë si vende të mbushura. Prandaj, në rast të mungesës së fëmijës për periudhë një mujore, prindërit duhet paguar gjysmën e çmimit të rregullt për secilin muaj që fëmija mungon.

## **Ditëlindjet**

Ditëlindjet për fëmijët e Kids Academy shënohen vetëm me fëmijët e KA, nën përkujdesjen e personelit të kopshtit. Për këtë ngjarje, Kids Academy kujdeset për pregaditjen e kombinimit të frutave apo biskotave, ndërsa prindërit lirohen nga sjellja e ëmbëlsirave apo stolive të tjera për fëmijët e tyre.

## **Fotografitë e Fëmijëve**

Fotografitë e fëmijëve tuaj të realizuara brenda kopshtit apo në aktivitete të organizuara nga kopshti, mund të publikohen në web faqen e Kids Academy si dhe në grupin e KA në Facebook. Këto fotografi publikohen për prindërit që dëshirojnë të jenë në rrjedha me aktivitetet e përditshme të fëmijëve të tyre në kopsht apo të ndajnë këto fotografi me familjarë dhe të afërm.

## **Kontaktimi i Personelit**

Për shkak se prezenca e telefonave në klasa pengon zhvillimin e planprogramit për fëmijë, prindërit nuk mund të kontaktojnë mësueset gjatë orarit të ditës. Gjatë këtij orari, ju mund të kontaktoni vetëm 1 herë në ditë, me Asistentin Administrativ i cili mund të ju informojë në mirëqenien e fëmijës suaj.

## **Largimi i Fëmijëve nga Kids Academy**

Prindërit të cilët për arsye të ndryshme dëshirojnë që të largojnë fëmijët nga programi i Kids Academy, dhe të përfundojnë bashkëpunimin, duhet njoftuar personelin e Kids Academy në formën e shkruar, së paku 1 muaj para largimit. Njoftimi mund të dërgohet me shkrim në zyrën e administratës, duke specifikuar arsyen e largimit, ose në email adresën elektronike [info@kidsacademy-ks.com](mailto:info@kidsacademy-ks.com). Kids Academy gjithashtu ka të drejtë që të largojë fëmijën nga kopshti dhe të përfundojë bashkëpunimin, në rast se rregullat e lartëshënuara nuk përfillen nga prindërit apo personat nën përkujdesjen e fëmisë.